8. Si përjashtim nga pika 1, e këtij neni, nëse pagesa është kryer nëpërmjet një ndërmjetësi që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse pagesa pa para në dorë është kryer nga blerësi direkt, pa ndërmjetës, nëse pagesa është kryer në bazë të një fature të lëshuar nga blloku i veçantë i faturave, sipas nenit 30, të këtij ligji, ose nëse pagesa është kryer sipas një oferte dhe përpara lëshimit të faturës elektronike, në përputhje me pikën 1, të nenit 7, të këtij ligji, atëherë vetë tatimpaguesi, që lëshon faturë, duhet që nëpërmjet platformës qendrore të faturave të regjistrojë të gjitha pagesat e pranuar, jo më vonë se ditën e dhjetë të muajit pasardhës, për të gjitha pagesat e kryera në muajin paraardhës.

9. Sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 8, të këtij neni, tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet të veprojë edhe në rast të kryerjes së pagesës nëpërmjet shkëmbimit, transferimit të të drejtave ose detyrimeve, heqjes dorë nga detyrimi dhe të ngjashme.

10. Të dhënat e pagesës, sipas këtij neni, dërgohen për të gjitha pagesat, pavarësisht nëse është paguar e gjithë shuma e faturës ose vetëm një pjesë e saj. Përjashtimisht, tatimpaguesi, që lëshon faturë, që regjistron vetë pagesat e marra, në përputhje me pikën 8, të këtij neni, shënon shumën totale të regjistruar për secilën faturë elektronike të muajit paraardhës.

11. Të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë nen zbatohen në mënyrën e duhur edhe në rast të anulimit apo ndryshimit të pagesës së bërë dhe për rimbursimin e pjesshëm ose të plotë të shumës së paguar për një faturë elektronike individuale. Nëse bëhet rimbursim i shumës së paguar, dërgohet një mesazh me të njëjtin informacion, sipas pikës 4, të këtij neni, me parashenjë të shumës negative të shumës së kthyer.

12. Detyrimet ligjore, që rrjedhin nga ky nen, zbatohen në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 38

Procedurat për regjistrimin në arkë, për pagesat me para në dorë

Tatimpaguesi, para lëshimit të faturës së parë, në fillim të çdo dite pune regjistron informacionin mbi



shumën fillestare të parave të çeljes së arkës për çdo pajisje elektronike të faturimit, nëpërmjet lidhjes elektronike (internetit) të vendosur me administratën tatimore qendrore. Tatimpaguesi regjistron në të njëjtën mënyrë edhe çdo shtim ose tërheqje të shumës në arkë gjatë ditës së punës

KREU XI FATURA SHOQËRUESE

Neni 39

Tatimpaguesit, që lëshojnë faturë shoqëruese

1. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura shoqëruese, janë tatimpagues që lëshojnë fatura sipas nenit 4, të këtij ligji, kur ata transportojnë mallra nga një vend në një tjetër në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa ndryshim të pronësisë.

2. Qëllimi i lëshimit të faturës shoqëruese nuk është krijimi i detyrimit tatimor, por monitorimi i lëvizjes së mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Fatura shoqëruese lëshohet nga tatimpaguesi sipas pikës 1, të këtij neni, menjëherë përpara transportit të mallrave nga një vend në një tjetër, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Fatura shoqëruese origjinale, riprodhuar si kod QR, duhet të shoqërojë lëvizjen e mallrave deri në destinacion.

4. Tatimpaguesit, që lëshojnë faturë shoqëruese, nuk duhet të regjistrohen në mënyrë të veçantë në regjistrin e administratës tatimore qendrore si lëshues të faturave shoqëruese përpara fillimit të lëshimit të faturave shoqëruese, por duhet të regjistrojnë vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga kryhet dërgimi i mallrave, në përputhje me përcaktimet e nenit 14 të këtij ligji.

5. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura shoqëruese, duhet të regjistrojnë informacionin mbi operatorin që lëshon faturat shoqëruese, në përputhje me përcaktimet e nenit 15 të këtij ligji.

6. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura shoqëruese, duhet të regjistrojnë informacionin për mirëmbajtësin e zgjidhjes software-ike, në përputhje me përcaktimet e nenit 16 të këtij ligji.

Neni 40

Të dhënat e detyrueshme të faturës shoqëruese

1. Fatura shoqëruese e lëshuar duhet të përpilohet në formën e përcaktuar me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat dhe duhet të përmbajë, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

- a) titullin “Faturë shoqëruese”;
- b) datën dhe kohën e lëshimit të faturës shoqëruese (orën dhe minutat);
- c) numrin e faturës shoqëruese;
- ç) numrin unik të identifikimit të tatimpaguesit, që lëshon fatura shoqëruese;
- d) emrin/emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, që lëshon fatura shoqëruese;
- dh) adresën e nisjes së mallrave;
- e) adresën e destinacionit të mallrave;
- ë) kodin e operatorit, të lëshuar në përputhje me nenin 15 të këtij ligji;
- f) kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, të lëshuar në përputhje me nenin 14 të këtij ligji;
- g) datën e transportit të mallrave;
- gj) sasinë dhe përshkrimin e mallrave që transportohen;
- h) emrin/emrin dhe mbiemrin, adresën dhe numrin unik të identifikimit të transportuesit, nëse transportuesi është i ndryshëm nga tatimpaguesi, që lëshon fatura shoqëruese;
- i) numrin e targave të automjetit me të cilin transportohen mallrat;
- j) numrin identifikues të veçantë të faturës shoqëruese (NIVFSH), i shprehur si shenjë alfanumerike;
- k) numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH), i shprehur si shenjë alfanumerike;
- l) kodin QR, që përmban të dhënat e përcaktuara me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

2. Tatimpaguesi, që lëshon faturën shoqëruese, pasi procedura e fiskalizimit është kryer me sukses, duhet të printojë vetëm kodin QR, sipas shkronjës “P”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Neni 12, i këtij ligji, zbatohet edhe për përcaktimin e numrit të faturës shoqëruese.



Neni 41

Zbatimi i procedurës së fiskalizimit të faturës shoqëruese

1. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura shoqëruese, duhet të instalojnë një pajisje elektronike dhe një printer, nëse pajisja dhe printeri nuk janë të integruara, për të printuar kodin QR të faturës shoqëruese, një zgjidhje software-ike, si dhe të sigurojnë lidhjen elektronike (internetin) për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore qendrore, në mënyrë që të kryhet procedura fiskalizuese për lëshimin e faturës shoqëruese.

2. Procedura e fiskalizimit, marrja e certifikatës elektronike, si dhe dispozitat e veçanta të procedurës së fiskalizimit për tatimpaguesit, që lëshojnë fatura shoqëruese, bëhet në përputhje me nenet 18, 19, 20, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji.

Neni 42

Detyrime të tjera

1. Përpara transportimit të mallrave nga një vend i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të tatimpaguesit te një tjetër, kodi QR i faturës shoqëruese duhet të printohet në letër dhe duhet të shoqërojë mallrat gjatë gjithë kohës së transportit, nga vendi i nisjes deri në destinacion.

2. Me kërkesë të punonjësit të administratës tatimore, tatimpaguesi ose transportuesi duhet të tregojë kodin QR të faturës shoqëruese për inspektim.

3. Kodi QR, i shtypur në letër, pas kryerjes së transportit mbahet në vendin e destinacionit të mallrave.

4. Tatimpaguesi, që lëshon fatura shoqëruese, duhet t'i ruajë këto për, të paktën, 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit fiskal, të cilit i përkasin dokumentet ose në të cilin janë lëshuar faturat shoqëruese, në letër apo në formë elektronike.

KREU XII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 43

Autoriteti përgjegjës

Ngarkohen për zbatimin dhe administrimin e këtij ligji administrata tatimore dhe AKSHI.

Neni 44

Sanksionet

Çdo veprim ose mosveprim i kryer nga tatimpaguesi, që bie ndesh me dispozitat e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet si e tillë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

Neni 45

Mbrojtja e të dhënave

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen duke respektuar dispozitat e ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Të dhënat personale, të mbledhura për qëllim të lëshimit të faturës dhe kryerjes së regjistrimeve të pagesave, mund të përdoren vetëm për këtë qëllim dhe për qëllim të këtij ligji ose për qëllime të tjera, që janë në përputhje me qëllimin e mbledhjes së këtyre të dhënave.

3. Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet blerësit ose klientit dhe ndërmjetësve të teknologjisë së informacionit ose tatimpaguesve, që lëshojnë fatura, dhe ofruesve të shërbimeve të teknologjisë së informacionit, apo pagesit të faturës elektronike dhe ndërmjetësit financiar, në rolin e administratorit dhe përpunuesit të të dhënave personale, të cilat përpunohen gjatë procedurës së lëshimit, marrjes, dërgimit, ruajtjes dhe përpunimit të faturave dhe procedurës së pagesave të faturave elektronike, rregullohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Të gjitha çështjet e tjera, që nuk mbulohen nga ky ligj, i nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore dhe dispozitave përkatëse të ligjeve të tjera në fuqi.



Neni 46

Dispozitat kalimtare

1. Për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri më 31 mars 2020, tatimpaguesit e rinj të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe administratës tatimore, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri më 31.3.2020, për çdo transaksion me para në dorë, lëshojnë faturë ose kupon ose dëftesë tatimore, si dhe dorëzojnë librin e blerjeve dhe librin e shitjeve, në formën dhe procedurën e përcaktuar në këtë ligj dhe/ose legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore dhe legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar. Nga data 1 prill 2020 deri në fillimin e efekteve, sipas nenit 48, të këtij ligji, këta tatimpagues mund të lëshojnë fatura në përputhje me këtë ligj ose kuponëve tatimorë dhe/ose dokumenteve të tjera, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

2. Për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri në fillimin e efekteve, sipas nenit 48, të këtij ligji, të gjithë tatimpaguesit e tjerë, subjekt i këtij ligji, të cilët kryejnë transaksione me para në dorë, mund të lëshojnë fatura në përputhje me këtë ligj ose kuponëve tatimorë dhe/ose dokumenteve të tjera, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

3. Për periudhën, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri në fillimin e efekteve, sipas nenit 48, të këtij ligji, të gjithë tatimpaguesit e tjerë, të cilët kryejnë transaksione pa para në dorë, zbatojnë të gjitha detyrimet, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimit mbi vlerën e shtuar.

4. Tatimpaguesit dhe administrata tatimore marrin të gjitha masat për kryerjen e testimit të sistemit elektronik, lidhur me procedurat e fiskalizimit të lëshimit të faturave, sipas parashikimeve të kreut V dhe nenit 18, të këtij ligji, që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 47

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për financat për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e tij.

2. Përjashtimisht përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, aktet nënligjore për zbatimin e neneve 26, 27, 28, 37, 40, 41 dhe 42 të këtij ligji, nxirren jo më vonë se data 1 qershor 2020.

Neni 48

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Përjashtimisht pikës 1, të këtij neni, në varësi të llojit të transaksionit, ky ligj i fillon efektet sipas grafikut të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të kësaj pike.

a) Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatim fitimit me të ardhura vjetore mbi 8 milionë lekë, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 shtator 2020.

b) Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatim të thjeshtuar mbi fitimin me të ardhura vjetore mbi 2 milionë lekë, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021.

c) Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me të ardhura vjetore deri në 2 milionë lekë, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021.

ç) Për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021.

d) Për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 korrik 2021.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 18.12.2019

**VENDIM
Nr. 12, datë 6.1.2020****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI
TË POSAÇËM SHTETËROR
Z. LEFTER ANDREA ÇIPA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”,



të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit,
Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Lefter Andrea Çipa, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 13, datë 6.1.2020

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI
TË POSAÇËM SHTETËROR
ZNJ. BUKUROSHE HASIP BELLOVA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror znj. Bukuroshe Hasip Bellova, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 14, datë 15.1.2020

**PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT
PËR VITIN 2020 NË INSTITUCIONET E
ADMINISTRATËS SHTETËRORE,
PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim, gjatë vitit 2020, është gjithsej 880, të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

a) Për Trupën e Nëpunësve Civilë të Nivelit të Lartë Drejtues 3;

b) Për kategorinë e mesme drejtuese 59;

c) Për kategorinë e ulët drejtuese 150;

ç) Për kategorinë ekzekutive 668.

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, në kategorinë ekzekutive, janë si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike;
- Audit i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;

- Histori-filologji;

- Shkenca mjekësore;

- Veterinari;

- Agronomi;

- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;

- Kimi;

- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;

- Shkenca inxhinierike;

- Arkitekturë;

- Arkeologji dhe restaurime;

- Artet e bukura;

- Gjeodezi;

- Shkenca ekzakte;

- Shkenca edukimi;

- Mësuesi;

- Arsimit i lartë ushtarak/policor;

- Arsimit i lartë.



3. Institucionet e administratës shtetërore, ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2020, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LIDHJA NR. 1

Lista e institucioneve të administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2020

1. Kryeministria dhe institucionet e saj të varësishë
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
3. Sistemi i Ministrisë së Brendshme
4. Ministria e Mbrojtjes
5. Sistemi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
6. Sistemi i Ministrisë së Drejtësisë
7. Sistemi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
8. Sistemi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
9. Sistemi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit
10. Sistemi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
11. Sistemi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë
12. Ministria e Kulturës

VENDIM

Nr. 17, datë 15.1.2020

PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT, FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të mëposhtme të nxitjes së punësimit:

- a) programit të punësimit;
- b) formimit nëpërmjet punës;
- c) praktikave profesionale.

2. Programet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, zbatohen në përputhje me nevojat individuale të punëkërkuësit për t'u integruar në tregun e punës dhe në planin individual të integruar për punësimin e tij.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit përcakton çdo vit prioritetet dhe miraton planin e zbatimit të fondeve të nxitjes së punësimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, pas propozimit nga drejtoria e përgjithshme e institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

II. KRITERET E APLIKIMIT

1. Punëkërkuësit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuësit e papunë të regjistruar dhe aktivë, për jo më pak se 3 (tre) muaj në zyrën e punës, pasi të kenë marrë shërbimet e nevojshme të punësimit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga specialisti përkatës i punësimit. Nevojat dhe profili i punëkërkuësit duhet të përshtaten me kërkesat për aftësi të vendit të lirë të punës të ofruar nga punëdhënësi.

2. Punëkërkuësi, pjesëmarrës në programet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nuk mund të zëvendësohet.

3. Një punëkërkuës mund të marrë pjesë vetëm një herë në të njëjtin program brenda një periudhe pesëvjeçare.

4. Punëdhënësit me të drejtë aplikimi duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të jenë shoqëri tregtare të regjistruara, për jo më pak se 6 (gjashtë) muaj;
- b) të mos jenë në proces falimentimi;
- c) të jenë subjekt i pagimit të taksave dhe të jenë të regjistruar si punëdhënës pranë autoriteteve tatimore;
- ç) të mos kenë shkelur legjislacionin për punësimin në dy vitet e fundit para aplikimit në program;
- d) të kenë paguar rregullisht të gjitha sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore;



dh) të ofrojnë punë me kohë të plotë, për një minimum prej 40 (dyzet) orësh në javë, me një pagesë mujore jo më pak se paga minimale, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës. Punësimi me kohë të pjesshme ose punët sezonale afatshkurtra nuk përfitojnë subvencionim;

e) të jenë shoqëri tregtare, të cilat nuk kanë detyrime ndaj organeve tatimore ose, në momentin e aplikimit në program, të vërtetojnë se:

i. kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullta në shlyerjen e tyre;

ii. kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjambat;

iii. kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe janë në proces të apelimit administrativ e në procese gjyqësore me organet tatimore;

ë) vendi i punës i financuar nga ky program duhet të vijë si rezultat i rritjes së fuqisë punëtore në aktivitetin e punëdhënësit;

f) nuk duhet të ketë pakësuar numrin e të punësuarve, duke reduktuar fuqinë punëtore brenda 4 (katër) muajve të kaluar.

5. Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë në më shumë se një program për një numër punëkërkuesish jo më të madh se 20 (njëzet) % të fuqisë punëtore aktuale, por jo më shumë se 21 (njëzet e një) pjesëmarrës. Punëdhënësit me më pak se 5 (pesë) punonjës mund të aplikojnë për maksimumi dy pjesëmarrës.

III. PROGRAMET, PËRFITUESIT DHE MBËSHTETJA

1. Programi i punësimit përmban elementet e mëposhtme:

a) programi i punësimit është një program njëvjeçar punësimi, në të cilin profili dhe nevojat e punëkërkuesit përshtaten me vendin e lirë nga punëdhënësi;

b) paga përcaktohet në kontratën e punës, në përputhje me pozicionin përkatës dhe nivelin e pagave në treg;

c) punëkërkuesit e papunë me të drejtë përfitimi nga programet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, janë nga kategoritë e mëposhtme:

i. të rinjtë me moshë nën 29 (njëzet e nëntë) vjeç;

ii. punëkërkuesit e papunë afatgjatë;

iii. punëkërkuesit me moshë mbi 45 (dyzet e pesë) vjeç;

iv. punëkërkuesit e papunë të pakualifikuar;

v. punëkërkues të papunë, të kthyer prej jo më shumë se 2 (dy) vjetësh nga emigracioni;

vi. punëkërkuesit që përfitojnë ndihmë ekonomike, duke trajtuar me prioritet përfituesit e ndihmës ekonomike, që parashikohet të dalin nga skema e ndihmës ekonomike në vitin përkatës dhe atë pasardhës;

vii. punëkërkuesit që marrin pagesa papunësie për më shumë se 3 (tre) muaj;

viii. personat me aftësi të kufizuara;

ix. viktimat e trafikimit, të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje;

x. punëkërkuesit nga komuniteti rom dhe egjiptian;

xi. personat që kanë përfunduar kursin e formimit profesional ose programin e formimit nëpërmjet punës dhe janë ende të papunë 6 (gjashtë) muaj pas përfundimit;

ç) programi subvencionon kostot e mëposhtme:

i. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së punësimit, të kompensuara çdo muaj;

ii. financimin e pagës në shumën 100 (njëqind) % të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi:

- për 4 (katër) muaj, për të gjithë pjesëmarrësit në program, të kompensuara në muajin e pestë dhe të gjashtë të kontratës, dhe në muajt e njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të kontratës;

- për 6 (gjashtë) muaj, për pjesëmarrësit, të cilët janë viktimat e trafikimit, të dhunës në familje apo viktimat e dhunës me baza gjinore, romë dhe egjiptianë, të kompensuara në muajin e katërt, të pestë, të gjashtë, të shtatë, të njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të kontratës;

- për 12 (dymbëdhjetë) muaj për pjesëmarrësit, persona me aftësi të kufizuara, të kompensuara çdo muaj.

2. Programi i formimit nëpërmjet punës përmban elementet e mëposhtme:

a) programi i formimit nëpërmjet punës ka si qëllim trajnimin në punë të punëkërkuesve, sipas nevojave të profilit të punës të kërkuar nga



punëkërkuessit dhe përshtatur me nevojat e punëdhënësit;

b) kohëzgjatja e subvencionimit të ofruar nga ky program do të jetë për një periudhë katërmujore për të gjitha profesionet;

c) plani individual i trajnimit hartohet nga punëdhënësi e miratohet nga strukturat përkatëse të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë;

ç) çdo punëdhënësi cakton të paktën një trajner për çdo grup përfituesish, nga një deri në shtatë persona përfitues, të përfshirë në program;

d) përfitues i këtij programi është punëkërkuessi i papunë dhe i pakualifikuar në profesionin e interesuar;

dh) programi subvencionon kostot e mëposhtme:

i. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së formimit, të kompensuara çdo muaj;

ii. financimin e pagës në shumën 100 (njëqind) % të pagës minimale në shkallë vendi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të kompensuara çdo muaj;

iii. kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit) për tetë muajt e ardhshëm, të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, në rastet, kur, pas përfundimit të formimit nëpërmjet punës, punëdhënësi lidh kontratë punësimi të paktën tetëmuajore me punëmarrësin pas përfundimit të programit;

iv. pagesën për mentorin në vlerën 2 000 (dy mijë) lekë për çdo përfitues, pjesëmarrës të angazhuar nga ky punëdhënësi.

3. Programi i praktikave profesionale përmban elementet e mëposhtme:

a) programi i praktikave profesionale ka si qëllim të garantojë tranzicion të shpejtë në tregun e punës, në të njëjtën fushë ose në një fushë të ngjashme me atë, në të cilën ka studiuar i diplomuari, për një kohëzgjatje 6-mujore;

b) përfitues të këtij programi janë të gjithë punëkërkuessit e papunë, të cilët janë të sapodiplomuar, deri në 24 (njëzet e katër) muajt e fundit pas diplomimit, të cilët janë regjistruar si punëkërkuess të papunë;

c) programi subvencionon kostot e mëposhtme:

i. kontributet për sigurimin nga aksidentet në punë;

ii. financim i pagës në shumën 50 (pesëdhjetë) % të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të kompensuara çdo muaj.

4. Përveç subvencionimit të kostove të mbuluara nga këto programe, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3, të këtij kreu, për përfituesit jetimë, prindër të vetëm me fëmijë nën 6 (gjashtë) vjeç, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, viktimat e viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore, përfitues të ndihmës ekonomike mbulohen edhe shpenzime të tjera, si më poshtë vijojnë:

a) bonuse për shpenzimet e transportit mbulohen për të gjitha kategoritë e mësipërme, të cilat kanë vendbanimin mbi 2 (dy) km nga vendi i punës, në vlerën prej 1 600 (një mijë e gjashtëqind) lekësh në muaj;

b) për prindërit e vetëm me një fëmijë nën 6 (gjashtë) vjeç jepet një bonus në vlerën prej 3 000 (tre mijë) lekësh në muaj për ndjekjen e kopshteve dhe të çerdheve për fëmijët në ngarkim;

c) deri në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë për përshtatjen e arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara për punëdhënësit.

IV. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT

Procedura e përgjithshme e zbatimit të këtyre programeve përfshin hapat, si më poshtë vijojnë:

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, nëpërmjet strukturave të tij, publikon informacionin e nevojshëm në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në platforma të tjera (faqe interneti, media sociale, shtyp etj.) lidhur me zbatimin e programeve dhe informon rregullisht punëdhënësit e punëkërkuessit e regjistruar.

2. Punëdhënësit mund të aplikojnë për përfshirjen në program në rrugë elektronike ose në zyrat përkatëse të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, duke ngarkuar në faqen e internetit ose duke dorëzuar fizikisht dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e aplikimit të plotësuar, sipas modelit standard të miratuar dhe publikuar nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë;

b) autorizimin e punëdhënësit, me të cilin autorizohet institucioni përgjegjës për punësimin



dhe aftësitë për të kryer të gjitha verifikimet dhe kërkimet e nevojshme të dokumenteve dhe të të dhënave të aplikimit;

c) vetëdeklarim për mospasjen në ngarkim të punëdhënësit, të shkeljeve apo të sanksioneve që lidhen me legjislacionin e punës, përgjatë dy viteve të fundit.

3. Pas marrjes së aplikimit nga punëdhënësi, struktura vendore e punësimit kryen verifikimet e përmbushjes së kriterëve të punëdhënësve, nëpërmjet dokumenteve të mëposhtme:

a) ekstraktit historik të punëdhënësit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

b) vërtetimit për pagimin e detyrimeve tatimore;

c) vërtetimit për derdhjen e kontributeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit.

4. Struktura vendore e punësimit verifikon, brenda 7 (shtatë) ditëve pune, plotësimin e kushteve formale paraprake të aplikimit dhe përputhshmërinë e tij me rregullat e zbatueshme të 3 (tri) programeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Në rast të mosplotësimit të kushteve paraprake, struktura vendore e punësimit i kërkon aplikuesit plotësimin e dokumentacionit.

6. Në rast të plotësimit të kushteve paraprake, struktura vendore i përcjell për miratim aplikimin strukturës rajonale të punësimit, e cila, brenda 5 (pesë) ditëve pune, vendos miratimin ose mosmiratimin e projektit, sipas rregullave të përcaktuara në manualin e zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit.

7. Struktura vendore e punësimit i komunikon punëdhënësit aplikues përgjigjen përfundimtare për pranimin apo refuzimin e aplikimit brenda 2 (dy) ditëve pune.

8. Punëdhënësi dhe punëkërkuksi, në cilësinë e punëmarrësit, lidhin një kontratë pune, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, në përputhje me programet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi. Një kopje e kontratës së punësimit dorëzohet në strukturën vendore të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, i cili do të monitorojë zbatimin e saj deri në përfundim të projektit.

9. Pas nënshkrimit të kontratës së punës nënshkruhet marrëveshja trepalëshe për zbatimin e programit.

10. Për pjesëmarrësit në program, të cilët kanë qenë përfitues të ndihmës ekonomike, institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë informon institucionin përgjegjës për shërbimin social.

11. Nëse punëdhënësi zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën me përfituesin, punëdhënësi është i detyruar të kthejë 100 (njëqind) % të mbështetjes financiare të përfituar deri në atë moment.

12. Nëse punëdhënësi nuk respekton marrëveshjen trepalëshe për zbatimin e programeve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ai përjashtohet nga pjesëmarrja në program për një periudhë katërvjeçare.

13. Financimi i punëdhënësit do të bëhet çdo muaj, pas verifikimit nga struktura përkatëse e punësimit të kryerjes së pagesës nga ana e tij.

14. Monitorimi i zbatimit kryhet nga strukturat përkatëse të punësimit (institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë).

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë përgatit raportin vjetor brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse të ndihmës shtetërore.

2. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë ruan të dhënat për programet 10 (dhjetë) vjet, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Vlerësimi i ndikimit të programeve kryhet çdo 4 (katër) vjet nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, nëpërmjet ekspertëve ose organizatave me përvojë në këtë fushë.

4. Afati i zbatimit të programeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 5 (pesë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 11.1.2012, “Për programin e nxitjes së punësimit të grave dhe të vajzave nga grupet e veçanta”, i ndryshuar; nr. 47 datë 16.1.2008, “Për programet e nxitjes së punësimit të punëkërkuksve të papunë nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar; nr. 48, datë 16.1.2008, “Për programet e nxitjes së punësimit të punëkërkuksve të papunë nga grupet e veçanta”, i ndryshuar; nr. 64, datë 27.1.2016, “Për programin e nxitjes së punësimit të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit”, i ndryshuar; nr. 162, datë 21.3.2018, “Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional”; nr. 199, datë



11.1.2012, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë të rinj”, i ndryshuar; nr. 248, datë 30.4.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”, i ndryshuar; nr. 873, datë 27.12.2006, “Për programet e nxitjes së punësimit të praktikave profesionale për punëkërkuësit që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit”, i ndryshuar, shfuqizohen.

6. Programet e miratuara me bazën ligjore, e cila shfuqizohet sipas pikës 5 të këtij kreu, vazhdojnë zbatimin, sipas kushteve të vendosura në momentin e miratimit të tyre.

7. Ngarkohet institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për hartimin e rregulloreve të zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM Nr. 19, datë 15.1.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS QË LIDH RRUGËT: ‘PJETËR BUDI’, ‘QAMIL GURANJAKU’ DHE ‘STAVRI VRINJAO’, TIRANË’

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti, “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës që lidh rrugët “Pjetër Budi”, “Qamil Guranjaku” dhe “Stavri Vrinjao”, Tiranë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “truall”, me vlerë 170 228 501 (njëqind e shtatëdhjetë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e një) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 170 228 501 (njëqind e shtatëdhjetë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Tiranë, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së



projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT "NDËRTIMI DHE RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS QË LIDH RRUGËT "PJETËR BUDI", "QAMIL GURANJAKU" DHE "STAVRI VRINJAO", TIRANË

Nr.	Emër mbiemër	ZK	Lloji i pasurisë	Nr. pas.	Sip. e përgj., truall m ²	Sip. e prekur, truall m ²	Çmimi për truall lekë/m ²	Vlera, lekë	KONFIRMIM NGA ZVRPP-ja, TIRANË
1	Adem Muharrem Joca, Mahmude Muharrem Joca	8160	Truall	4/349	618	528	66,969.00	35,359,632.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
2	Adem Muharrem Joca, Mahmude Muharrem Joca	8160	Truall	4/350	365	360	66,969.00	24,108,840.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
3	Adem Muharrem Joca, Mahmude Muharrem Joca	8160	Truall	4/351	56	56	66,969.00	3,750,264.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
4	Drita H. Male, Gezim H. Male, Mimoza H. Male, Neriman Xh. Male, Ilirjan A. Male, Altin A. Male, Enkelelda A. Male.	8160	Truall	4/357	148	57	66,969.00	3,817,233.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
5	Ymer Halit Jonuzi	8160	Truall	4/739	69	29.7	66,969.00	1,988,979.30	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
6	Arjan Spiro Syziu	8160	Truall	4/749	101	12.5	66,969.00	837,112.50	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
7	14 Bashkëpronarët Myzyri, Jashari, Cela	8160	Truall	4/834	96	43	66,969.00	2,879,667.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
8	Fejzi Isa Domni	8160	Truall	4/216	261	239	66,969.00	16,025,681.70	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
9	Ymer Halit Jonuzi	8160	Truall	4/743	81	81	66,969.00	5,424,489.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
10	Mylazim Islam Deharaj	8160	Truall	4/404	250.00	239.5	66,969.00	16,039,075.50	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
11	Edrin Koço Katundi	8160	Truall	4/403	30	30	66,969.00	2,009,070.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
12	Gezim Halil Peshkopia Anila Ruzhdi Peshkopia	8160	Truall	4/332	100	13.9	66,969.00	930,869.10	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
13	Aishe - Gori, Jemin Kasem Skenderi, Met - Murati, Ndreke Ndoc Pjetruishi, Namik Hoxha	8160	Truall	4/451	73	73	66,969.00	4,888,737.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
14	Sotiraj Vasil Naçi	8160	Truall	4/452	17	17	66,969.00	1,138,473.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
15	Sotiraj Vasil Naçi	8160	Truall	4/712	22	22	66,969.00	1,473,318.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
16	Bashkëpronarët Lohja, Muça, Çoku, Hasmuça	8160	Truall	4/766	378	378	66,969.00	25,314,282.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
17	Myzafer Xhevit Alilaj	8160	Truall	4/335	22	22	66,969.00	1,473,318.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
18	Zaçë Karafil Islamaj	8160	Truall	4/767	22	22	66,969.00	1,473,318.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
19	Krisanthi Gogo Jani	8160	Truall	4/377	88	46	66,969.00	3,080,574.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
20	Krisanthi Gogo Jani	8160	Truall	4/381	50	50	66,969.00	3,348,450.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
21	Elvana Stefan Spaho (Prifti)	8160	Truall	4/786	222	222	66,969.00	14,867,118.00	Konfirm. ZVRPP-ja, me shkresën nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019
SHUMA TOTALE E SHPRONËSIMIT								170,228,501	

SHËNIME:

- Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
- Pasuritë e prekurra nga projekti konfirmohen nga ZVRPP-ja, Tiranë, me shkresat nr. prot. 1340/1, datë 30.1.2018; me nr. prot. 1340/3, datë 27.2.2018; me nr. prot. 12248/1, datë 30.5.2018, dhe me nr. prot. 41481/1, datë 31.1.2019.



VENDIM

Nr. 20, datë 15.1.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 378, DATË 26.4.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT: “RIKUALIFIKIMI URBAN I
BLLOKUT TË KUFIZUAR NGA
RRUGËT: ‘SULEJMAN DELVINA’,
‘MEDAR SHTYLLA’, ‘SKËNDER
LUARASI’, ‘GRIGOR HEBA’ DHE
‘GJIK KUQALI’, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 378, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 378, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, i bëhen ndryshimet dhe shtesat e paraqitura në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) në pikën 4, vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga 115 185 048 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyzet e tetë) lekë, bëhet 133 310 401 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e treqind e dhjetë mijë e katërqind e një) lekë dhe do të përballohet nga fondet e buxhetit të Bashkisë Tiranë;

c) në pikën 5, vlera e përgjithshme e shpenzimeve procedurale nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë bëhet 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe do të përballohet nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



